



QENDRA
KINEMATOGRAFIKE
E KOSOVËS

Qendra Kinematografike e Kosovës, në bazë të nenit 14 të Ligjit Nr. 08/L-202 për Kinematografinë dhe Rregullores (MKRS) Nr. 02/2023 për konkurset dhe mbështetjen financiare të veprave filmike dhe audio-vizuale shpall:

**KONKURS PËR MBËSHTETJE PËR SHKRIM TË SKENARIT PËR FILM TË
METRAZHIT TË GJATË - ARTISTIK DHE I ANIMUAR - (mbi 60 minuta)
Ref. Nr. QKK 10/2026**

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë personat juridikë, vendorë ose të huaj, të regjistruar në Kosovë si subjekte biznesi për prodhimin e filmit, të cilët janë të regjistruar paraprakisht në Qendrën Kinematografike të Kosovës (QKK) dhe i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs.

Qëllimi i kësaj thirrjeje është të mbështesë procesin krijues të skenaristit në një stad të hershëm dhe të nxisë zhvillimin e ideve origjinale kinematografike.

Shuma e subvencionit për çdo projekt në këtë kategori është 4,000 euro, dhe është e dedikuar për mbështetjen e Skenaristit në procesin e shkrimit të skenarit. Pavarësisht nga forma e aplikimit, **mbështetja financiare i dedikohet ekskluzivisht skenaristit**, si mbështetje për procesin e shkrimit dhe zhvillimin autorial të projektit.

I. Aplikimi

Aplikimi bëhet përmes emailit: konkurset.qkk@rks-gov.net

- Në subjektin (Subject) të emailit duhet të shënohet kategoria e aplikimit me numër të referencës dhe emri i projektit, sipas shembullit më poshtë:

Ref. Nr. QKK 10/2026 - Emri i Projektit

Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të bashkëngjiten si **PDF Files veç e veç në email**, sipas renditjes në paragrafin II.

Madhësia totale e të gjitha dokumenteve të bashkëngjitura nuk duhet të tejkalojë 20 MB.

Sqarim:

Në rast se aplikuesi dërgon më shumë se një aplikim për të njëjtin projekt në të njëjtën kategori, vetëm aplikimi i dërguar përmes emailit të parë do të merret parasysh. Brenda 48 orëve, aplikuesi do të pranojë konfirmimin për pranimin e aplikimit.

Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar diskualifikohen, në përputhje me Rregulloren (MKRS) Nr. 02/2023¹ për Konkursat dhe Mbështetjen Financiare të Veprave Filmike dhe Audio-vizuale, Neni 12, pika 1.

Tarifa e aplikimit:

Aplikimi për Konkursin për Mbështetje për Shkrim të Skenarit për Film të Metrazhit të Gjatë - Artistik dhe të Animuar kushton 50 € (pesëdhjetë euro).

Mënyra e pagesës së aplikimit:

Fletëpagesa merret në zyret e QKK-së dhe duhet të dorëzohet fizikisht së bashku me konfirmim të pagesës në zyret e QKK-së.

II. Dokumentet e kërkuara

1. Forma e Aplikimit, së bashku me testin e kulturës (të shkarkohet nga Website i QKK);
2. Sinopsis;
3. Tritment;
4. Biografia dhe Filmografia e Skenaristit;
5. Skenar (10-20 faqe të shkëputura nga skenari);
6. Deklaratën/dëshminë e të drejtave autoriale;
7. Vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), që dëshmon se aplikuesi nuk ka obligime tatimore të pashlyera.
8. Dokumente të tjera relevante që mund t'i ndihmojnë aplikimit.

Kujdes: Të gjitha dokumentet duhet të bashkëngjiten veç e veç dhe **madhësia totale e dokumenteve të bashkëngjitura nuk duhet të tejkalojë 20 MB.**

II. KUFIZIMET NË PJESËMARRJE

1. Të drejtë aplikimi në këtë kategori kanë skenaristët, të cilët mund të aplikojnë individualisht, ose në bashkëpunim me një regjisor apo producent.
2. Shtëpitë filmike që janë me vonesë në zbatimin e kontratave paraprake nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
3. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë konkurimi me më shumë se tri projekte brenda konkursit.
4. Projektet që kanë filluar me xhirime nuk mund të aplikojnë në këtë kategori.
5. Projektet që janë refuzuar tre herë në thirrjet e mëparshme nuk kanë të drejtë aplikimi.

Vërejtje - referuar Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit: punëtorët e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit, dhe institucioneve vartëse të saj, nuk kanë të drejtë aplikimi në Konkurs.

Konkursi është i hapur nga data 23.09.2026 deri më 25.10.2026, në orën 00:00.